



BPAL - PIHA
Kolegji Universitar "BIZNESI"
University College "BIZNESI"
Prishtinë

Në bazë të nenit 11 të Statutit të Kolegjit Universitar "Biznesi" në Prishtinë, Këshilli i Lartë Mësimor-Shkencor i Kolegjit Universitar "Biznesi" më 14. 07. 2010 miratoi këtë:

RREGULLORE

PËR PËRCAKTIMIN E POLITIKAVE NË KOLEGJIN UNIVERSITAR "BIZNESI" PËR PROGRAMIN PUNË-STUDIM

Me këtë Rregullore përcaktohen kushtet që studentët të përfitojnë nga programi punë-studim në përputhje me politikën financiare të Kolegjit Universitar "Biznesi" (KU "Biznesi").

1. Punë-studim

- 1.1 Si pjesë e pakos për ndihmë financiare KU "Biznesi" u ofron studentëve mundësi për punësim në programin *punë-studim* sipas kushteve të mëposhtme.
 - Paga e studentit nuk mund të tejkalojë koston e mësimin;
 - Studentëve të angazhuar në këtë program u lejohej të punojnë më së shumti 15 orë në javë;
 - Përzgjedhja e studentëve bëhet në bazë të aftësive dhe suksesit.
- 1.2 Të gjithë studentët kanë të drejtë aplikimi në programin *punë-studim*, por përparësia do t'u jepet studentëve të cilët dëshmojnë se janë në vështirësi financiare.
- 1.3 Përfshihet mundësia që studentët të punojnë dy vite radhazi në këtë program.
- 1.4 Studentët që janë akorduar me bursë apo ndihmë financiare nuk lejohen të punojnë në të njëjtin vit akademik.
- 1.5 Studentët që dëshirojnë të përfitojnë nga kjo mundësi duhet të paraqesin kërkesë në Zyrën për ndihmë financiare. Kjo zyrë është përgjegjëse për njoftimin e vendeve të lira të punës si dhe për përpunimin dhe shqyrtimin e kërkesave.

- 1.6 Kërkesat, pasi të përpunohen dhe të shqyrtohen do të dërgohen në departamentin përkatës, në zyrën përkatëse ose në seksionin e Departamentit përkatës për shqyrtim të mëtejshëm.
- 1.7 Seksioni, departamenti ose zyra që ka nevojë për një vend do të thotë fjalën e fundit për marrjen në punë.

Prof. Dr. Shyqeri Kabashi

Dekan